



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

**PËR  
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURËS, MËNYRËS SË TRANSFERIMIT TË  
MENAXHIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË PESHKIMIT DHE INFRASTRUKTURËS  
SË LIDHUR ME PESHKIMIN DHE MIRATIMIN E KONTRATËS TIP**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 65, të Ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave,

**V E N D O S I:**

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e kriterëve, procedurave, mënyrës së transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin, rregullimin e monitorimit të tyre, si dhe miratimin e kontratave tip.

**Neni 2**

Termet e përdorur në këtë vendim kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar.

**Neni 3**

Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës menaxhon në mënyrë të drejtpërdrejtë infrastrukturën e peshkimit dhe infrastrukturën e lidhur me peshkimin dhe, në rast pamundësie teknike ose menaxhimi jo eficient, mbi bazën e raportit të kryer sipas nenit 4 të këtij kreu, kryen procedurat e transferimit të menaxhimit të tyre.

#### **Neni 4**

Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës harton një raport të argumentuar, i cili përmban vlerësimin ekonomik dhe arsyet teknike ose të eficiencës që justifikojnë transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin, i cili i përcillet ministrit për miratim.

#### **Neni 5**

Transferim, në kuptim të këtij vendimi, konsiderohet transferimi i së drejtës së menaxhimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, dhe nënkupton ushtrimin e të drejtës së administrimit dhe përdorimit të infrastrukturës, pa transferim të pronësisë apo krijim të të drejtave reale mbi të.

### **KREU II**

#### **PROCEDURA E TRANSFERIMIT TË MENAXHIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË PESHKIMIT TEK ORGANIZATAT E PESHKIMIT PA KONKURIM**

##### **Neni 1**

Menaxhimi i infrastrukturës së peshkimit i transferohet organizatës së peshkimit të njohur nga ministri, kur institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës, mbi bazën e raportit sipas nenit 4 të Kreut I të këtij vendimi, është në pamundësi të menaxhimit të drejtpërdrejtë të saj.

##### **Neni 2**

Procedura e transferimit të infrastrukturës së peshkimit tek organizata e peshkimit, kur në këtë infrastrukturë vepron vetëm një organizatë e njohur nga ministri, fillon me iniciativë të institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës dhe bëhet pa konkurrim.

##### **Neni 3**

Në rastin kur infrastruktura e peshkimit ndodhet në një zonë bashkëmenaxhuese, ku vepron një organizatë menaxhimit peshkimi, në vijim OMP, e njohur nga ministri, atëherë infrastruktura në fjalë i transferohet OMP-së pa konkurrim.

##### **Neni 4**

1. Pas miratimit të raportit sipas nenit 4 të Kreut I të këtij vendimi nga ministri përgjegjës për peshkimin, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës njofton organizatën e peshkimit të njohur nga ministri, e cila vepron në zonën ku ndodhet infrastruktura e peshkimit në fjalë.
2. Njoftimi publikohet në faqen zyrtare të institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës.

### **Neni 5**

Organizata e peshkimit, brenda 15 ditëve, paraqet pranë institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës këtë dokumentacion:

1. Kërkesë për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës;
2. vendimin e regjistrimit, aktin e themelimit dhe statutin;
3. vendimin e organeve vendimmarrëse të organizatës së peshkimit për këtë qëllim, sipas statutit të saj;
4. planin për menaxhimin e infrastrukturës së peshkimit, të miratuar nga organet drejtuese të organizatës së peshkimit;
5. dokumentacion mbi kapacitetin teknik dhe financiar për zbatimin e planit të menaxhimit.

### **Neni 6**

Plani i menaxhimit duhet të përmbajë minimalisht:

1. qëllimin dhe objektivat;
2. rezultatet e pritshme;
3. burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare;
4. mënyrën e realizimit dhe monitorimit të objektivave;
5. planifikimin e investimeve;
6. organizimin e punës dhe ndarjen e detyrave.

### **Neni 7**

Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës ngre një komision të përbërë nga 3 (tre) anëtare: një jurist, një ekonomist dhe një specialist në fushën e peshkimit, i cili brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës, shqyrton dhe vlerëson kërkesën e organizatës së peshkimit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

### **Neni 8**

Komisioni shqyrton dhe vlerëson planin e menaxhimit për përputhshmërinë e tij me kërkesat e këtij vendimi, në bazë të kriterëve të mëposhtme:

1. investimet e parashikuara;
2. plani për sigurinë e infrastrukturës;
3. cilësia e shërbimit;
4. kostot operative.

### **Neni 9**

1. Gjatë kësaj periudhe, komisioni mund të kërkojë sqarime mbi planin e menaxhimit nga organizata e peshkimit.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga perfundimi i afatit për shqyrtimin e dokumentacionit, komisioni i paraqet titullarit të institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës një raport përmbledhës të arsyetuar dhe i propozon miratimin ose refuzimin e kërkesës për transferim.
3. Titullari i institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës merr vendim mbi bazën e propozimit të komisionit brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së tij.

#### **Neni 10**

1. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës lidh kontratën për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit sipas shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, brenda 20 (njëzet) ditëve nga miratimi sipas neni 9 të këtij kreu.
2. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës njofton ministrin për lidhjen e kontratës brenda 5 (pese) ditëve nga lidhja e saj.

#### **Neni 11**

Kontrata për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit lidhet me organizatën e peshkimit ose OMP për një afat deri në 10 vjet.

#### **Neni 12**

Organizata e Peshkimit, me transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit, zbaton kushtet e vendosura nga neni 64, i ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar duke garantuar mosndryshimin e destinacionit dhe të qëllimit, përdorimin e infrastrukturës së peshkimit nga ana e shtetit në rastet e masave të jashtëzakonshme, ruajtjen dhe garantimin e interesit publik, ruajtjen dhe rritjen e vlerës ekonomike të strukturave portuale të peshkimit, që i janë dhënë në përdorim.

#### **Neni 13**

Organizata e peshkimit është përgjegjëse për shfrytëzimin racional të infrastrukturës së peshkimit, me qëllim mbështetjen e zhvillimit normal të veprimtarisë së peshkimit dhe tregtimit të produkteve të peshkimit.

#### **Neni 14**

Të ardhurat e krijuara nga menaxhimi i infrastrukturës perdoren nga organizata e peshkimit për mirëmbajtjen dhe funksionimin e saj.

### **KREU III**

#### **PROCEDURA E TRANSFERIMIT TË MENAXHIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË PESHKIMIT TEK ORGANIZATAT E PESHKIMIT ME KONKURRIM**

##### **Neni 1**

Në rast se në të njëjtën zonë vepron më shumë se një organizatë peshkimi, procedura e transferimit zhvillohet nga institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës nëpërmjet konkurrimit.

##### **Neni 2**

Njoftimi për transferimin e infrastrukturës së peshkimit publikohet në faqen zyrtare të ministrisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, duke përcaktuar të dhënat kryesore të infrastrukturës që do të transferohet, dokumentacionin që duhet të paraqesin organizatat e peshkimit, si dhe afatin e aplikimit.

### **Neni 3**

1. Konkurrimi kryhet në portalin unik qeveritar “e-Albania”.
2. Afati për paraqitjen e aplikimeve për transferim dhe dokumentacionin të kërkuar është 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga publikimi i njoftimit.

### **Neni 4**

Organizata e peshkimit ngarkon në portalin unik qeveritar “e-Albania” dokumentacionin e kërkuar, si më poshtë:

1. Kërkesë për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës;
2. Vendimin e regjistrimit, aktin e themelimit dhe statutin;
3. Vendimin e organeve vendimmarrëse të organizatës së peshkimit për këtë qëllim, sipas statutit të saj;
4. Planin për menaxhimin e infrastrukturës së peshkimit, të miratuar nga organet drejtuese të organizatës së peshkimit, me përmbajtje sipas nenit 6 kreu I të këtij vendimi.
5. Dokumentacion mbi kapacitetin teknik dhe financiar për zbatimin e planit të menaxhimit.

### **Neni 5**

Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës ngre një komision të përbërë nga 3 (tre) anëtarë: një jurist, një ekonomist dhe një specialist në fushën e peshkimit, i cili shqyrton dhe vlerëson aplikimet e paraqitura.

### **Neni 6**

1. Komisioni shkarkon dokumentacionin e ngarkuar në format elektronik në portalin “e-Albania”, ruan një kopje elektronike të tij dhe brenda 20 (njetzet) ditëve kalendarike, shqyrton dhe vlerëson kërkesat dhe dokumentacionin e ngarkuar nga organizatat e peshkimit.
2. Në qoftë se kërkesa e organizatës së peshkimit nuk është paraqitur, në përputhje me nenin 4, të këtij kreu, organizates i kërkohet, që të korrigjojë pasaktësitë ekzistuese, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit. Kur organizata e peshkimit plotëson pasaktësitë brenda afatit të përcaktuar, aplikimi quhet i regjistruar nga dita që është dërguar. Kur nuk plotëson pasaktësitë brenda afatit të caktuar, aplikimi refuzohet dhe i kthehet bashkë me aktet e tjera.

### **Neni 7**

Komisioni vlerëson plan menaxhimin dhe rendit aplikimet sipas kritereve të mëposhtme:

1. investimet e parashikuara;
2. plani për sigurinë e infrastrukturës;
3. cilësia e shërbimit;
4. kostot operative.

#### **Neni 8**

1. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit për shqyrtimin e dokumentacionit, komisioni i paraqet titullarit të institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës një raport përmbledhës të arsyetuar dhe propozon subjektin fitues të procedurës.
2. Titullari i institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës, mbi bazën e propozimit të komisionit, merr vendim për miratimin e subjektit fitues brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga paraqitja e tij.

#### **Neni 9**

1. Komisioni njofton organizatat aplikuese mbi vendimin brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e vendimit të titullarit.
2. Vendimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të ministrisë.

#### **Neni 10**

1. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga marrja e njoftimit të vendimit organizata e peshkimit ka të drejtën të paraqesë ankim administrativ pranë ministrisë përgjegjëse për peshkimin.
2. Ankimi shqyrtohet brenda 20 ditëve pune nga një komision i ngritur me urdhër të ministrit, të përbërë nga 3 (tre) anëtare: një jurist, një ekonomist dhe një specialist në fushën e peshkimit.

#### **Neni 11**

1. Pas përfundimit të afatit të paraqitjes së ankimit ose të shqyrtimit të ankesave, nëse ka, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës lidh kontratën sipas shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga njoftimi të vendimit.
2. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës njofton ministrin për lidhjen e kontratës brenda 5 (pesë) ditëve nga lidhja e saj.

#### **Neni 12**

Kontrata për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit lidhet me organizatën e peshkimit për një afat deri në 10 (dhjetë) vjet.

#### **Neni 13**

Organizata e peshkimit zbaton kushtet e vendosura nga neni 64, i ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, duke garantuar mosndryshimin e destinacionit dhe të qëllimit, ruajtjen dhe garantimin e interesit publik, ruajtjen dhe rritjen e vlerës ekonomike të infrastrukturës të peshkimit, që i është dhënë në menaxhim.

#### **Neni 14**

Të ardhurat e krijuara nga menaxhimi i infrastrukturës përdoren nga organizata e peshkimit për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së peshkimit.

## **Neni 15**

Organizata e peshkimit menaxhon infrastrukturën e peshkimit ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, duke garantuar perdorimin e saj ne menyre racionale, per te nxitur mbrojtjen e mjedisit e te atij detar dhe nje zhvillim te qendrueshem.

## **KREU IV**

### **PROCEDURA E TRANSFERIMIT TE MENAXHIMIT TE INFRASTRUKTURËS SË LIDHUR ME PESHKIMIN TE NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE**

#### **Neni 1**

Menaxhimi i infrastrukturës së lidhur me peshkimin i transferohet njësisë të vetëqeverisjes vendore nën juridiksionin territorial të së cilës ndodhet kjo infrastrukturë, kur institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës, mbi bazën e raportit sipas nenit 4, të kreut I të këtij vendimi, është në pamundësi të menaxhimit të drejtpërdrejtë të saj.

#### **Neni 2**

Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës dërgon raportit sipas nenit 4 të Kreut I të këtij vendimi për miratim nga ministri, me qëllim fillimin e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së lidhur me peshkimin tek njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

#### **Neni 3**

Pas miratimit të raportit nga ministri, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës i drejtohet me shkresë zyrtare njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, duke kërkuar shprehjen e interesit për menaxhimin e infrastrukturës së lidhur me peshkimin, ku përcaktohen edhe kriteret e transferimit të menaxhimit.

#### **Neni 4**

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e shkresës sipas nenit 3 të këtij kreu, paraqet shprehjen e interesit për menaxhimin e infrastrukturës së lidhur me peshkimin.

Në rast të shprehjes së interesit, njësitë e vetëqeverisjes vendore paraqet planin e menaxhimit, si dhe autorizimin nga Këshilli Bashkiak për lidhjen e kontratës.

#### **Neni 5**

Plani i menaxhimit përcakton qëllimin, objektivat e vendosura, rezultatet e pritshme dhe burimet e nevojshme njerëzore, financiare, arritjen e objektivave, ndjekjen e ecurisë së punës gjatë fazave të ndryshme të saj, parashikimin e investimeve, organizimin së bashku me ndarjen e detyrave.

Plani i menaxhimit duhet të përmbajë minimalisht:

1. qëllimin dhe objektivat;
2. rezultatet e pritshme;
3. burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare;
4. mënyrën e realizimit dhe monitorimit të objektivave;
5. planifikimin e investimeve;
6. organizimin e punës dhe ndarjen e detyrave.

#### **Neni 6**

Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës ngre një komision të përbërë nga 3 (tre) anëtarë: një jurist, një ekonomist dhe një specialist në fushën e peshkimit, për shqyrtimin e planit të menaxhimit të paraqitur nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Komisioni brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës, shqyrton dhe vlereson planin e menaxhimit dhe i paraqet titullarit të institucionit përgjegjës një propozim për miratimin ose jo të tij.

#### **Neni 7**

1. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës lidh kontratën për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së lidhur me peshkimin me njësinë e vetëqeverisjes vendore, brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga miratimi i planit të menaxhimit.
2. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës njofton ministrin për lidhjen e kontratës brenda 5 ditëve nga lidhja e saj.

#### **Neni 8**

Kontrata për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së lidhur me peshkimin lidhet me njësinë e vetëqeverisjes vendore për një afat deri në 10 (dhjetë) vjet, sipas shtojcës II të këtij vendimi.

#### **Neni 9**

Njësia e vetëqeverisjes vendore merr përsipër përballimin e kostove të përdorimit dhe të mirëmbajtjes së infrastrukturës së lidhur me peshkimin, përfshirë taksat e aplikueshme nga legjislacioni në fuqi dhe është përgjegjëse për mirëmbajtjen e saj.

#### **Neni 10**

Njësia e vetëqeverisjes vendore me transferimin e infrastrukturës së lidhur me peshkimin, garanton mosndryshimin e destinacionit dhe të qëllimit, ruajtjen dhe garantimin e interesit publik, ruajtjen dhe rritjen e vlerës ekonomike të saj, në përputhje me kushtet e kontratës dhe legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 11**

Njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse për shfrytëzimin racional të infrastrukturës së lidhur me peshkimin, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të veprimtarisë së peshkimit dhe tregtimit të produkteve peshkore, duke zbatuar legjislacionin në fuqi.

### **KREU V**

#### **PROCEDURA E TRANSFERIMIT TE MENAXHIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË LIDHUR ME PESHKIMIN TEK SUBJEKTET PRIVATE ME KONKURIM PUBLIK**

#### **Neni 1**

Menaxhimi i infrastrukturës së lidhur me peshkimin mund t'u transferohet subjekteve private nëpërmjet konkurrimit publik, në rast se njësia e vetëqeverisjes vendore, në juridiksionin territorial të së cilës ndodhet kjo infrastrukturë, nuk shpreh interes për menaxhimin e saj. Ky transferim nuk përbën kalim të pronësisë dhe nuk krijon të drejta reale mbi pasurinë.

## Neni 2

1. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturën akuakulturës dërgon raportit sipas nenit 4 të Kreut I të këtij vendimi për miratim miratimin nga ministri, me qëllim fillimin e për transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së lidhur me peshkimin tek subjektet private
2. Pas miratimit të raportit nga ministri përgjegjës për peshkimin, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës përgatit dhe publikon njoftimin për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së lidhur me peshkimin në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të ministrisë.
3. Njoftimi përcakton të dhënat kryesore të infrastrukturës që do të transferohet, kriteret e konkurrimit sipas nenit 3 të këtij kreu, dokumentacionin që duhet të paraqesin ofertuesit, si dhe afatin e paraqitjes së ofertave.

## Neni 3

Kriteret e konkurrimit për transferimin e menaxhimit janë si vijon:

1. përputhshmëria e aktivitetit me legjislacionin për peshkimin;
2. niveli i investimeve për përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve higjeno-sanitare;
3. plani për sigurinë e infrastrukturës;
4. cilësia e shërbimit;
5. kostot operative;
6. niveli i punësimit;
7. oferta e detyrimit mujor të qirasë.

## Neni 4

Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës përgatit dokumentacionin si më poshtë:

1. propozimin për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës;
2. miratimin e ministrit;
3. genplanin e objektit, në 4 (katër) kopje origjinale, të hartuar nga eksperti topograf i licencuar dhe të konfirmuar nga titullari i institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akukulturës
4. tarifën dysheme të qirasë;
5. konfirmimin nga institucioni përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme për pronësinë shtet të objektit, si dhe nga institucioni përgjegjës për kthimin dhe kompensimin e pronave për vendimet që mund të ketë dhënë për njohje ose kthim prone sipërfaqen në të cilën ndodhet ky objekt.

## Neni 5

Konkurrimi kryhet në portalin unik qeveritar “e-Albania”. Afati për paraqitjen e aplikimeve dhe dokumentacionit përkatës është jo më pak se 20 (njëzet) ditë kalendrike nga publikimi i njoftimit.

## Neni 6

Subjekti privat ngarkon në portalin unik qeveritar “e-Albania” dokumentacionin e mëposhtëm:

1. formularin e ofertës;

2. planin biznesi për menaxhimin
3. dokumentacion që provon kapacitetin teknik dhe përvojën në veprimtari të lidhura me peshkimin ose menaxhimin e infrastrukturës;
4. dokumentacion që provon aftësinë financiare për realizimin e investimeve të parashikuara;
5. deklaratën për përgjegjësinë ligjore mbi vërtetësinë e të dhënave dhe dokumentacionit të paraqitur;
6. deklaratë për mungesën e konfliktit të interesit.

#### **Neni 7**

1. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës ngre një komision të përbërë nga 3 (tre) anëtarë: një jurist, një ekonomist dhe një specialist në fushën e peshkimit.
2. Komisioni, brenda 20 (njëzet) ditëve nga përfundimi i afatit të paraqitjes së aplikimeve, shqyrton dhe vlerëson ofertat e paraqitura, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 3 të këtij kreu, si dhe bën renditjen e tyre.
3. Në qoftë se kërkesa e subjektit të interesuar nuk është paraqitur, në përputhje me nenin 6, të këtij kreu, subjektit i kërkohet, që të korrigjojë pasaktësitë ekzistuese, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit. Kur subjekti i interesuar plotëson pasaktësitë brenda afatit të përcaktuar, aplikimi quhet i regjistruar nga dita që është dërguar. Kur nuk plotëson pasaktësitë brenda afatit të caktuar, aplikimi refuzohet dhe i kthehet subjektit bashkë me aktet e tjera.

#### **Neni 8**

1. Komisioni vlerëson planin biznesin sipas kriterëve të mëposhtme:
  - a) investimet e parashikuara;
  - b) plani për sigurinë e infrastrukturës;
  - c) cilësia e shërbimit;
  - d) kostot operative.
2. Në përfundim të vlerësimit, komisioni bën renditjen e ofertave dhe identifikon ofertën ekonomikisht dhe teknike më të favorshme.

#### **Neni 9**

1. Komisioni paraqet për miratim, tek titullari i institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës, vendimin mbi kërkesën për transferim i cili konfirmon procedurën brenda 5 ditëve.
2. Komisioni, në përfundim të vlerësimit, i paraqet titullarit të institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës një raport përmbledhës të arsyetuar dhe propozon subjektin fitues të procedurës.
3. Titullari i institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës, mbi bazën e propozimit të komisionit, merr vendim për shpalljen e subjektit fitues brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e tij.

#### **Neni 10**

Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës publikon vendimin për shpalljen e subjektit fitues në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të ministrisë, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e tij.

#### **Neni 11**

1. Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit të vendimit subjekti ka të drejtën e ankimit pranë ministrisë përgjegjëse për peshkimin. Ankimi shqyrtohet brenda 30 ditëve nga një komision i ngritur me urdhër të ministrit të përbërë nga 3 (tre) anëtare: një jurist, një ekonomist dhe një specialist në fushën e peshkimit.

#### **Neni 12**

1. Pas shpalljes së subjektit fitues dhe përfundimit të afatit për paraqitjen e ankimit ose të shqyrtimit të ankesave, nëse ka, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës lidh kontratën sipas shtojcës III, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga përfundimi i këtij afati.
2. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës njofton ministrin për lidhjen e kontratës brenda 5 (pesw) ditëve nga lidhja e saj.

#### **Neni 13**

Kontrata për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së lidhur me peshkimin lidhet me subjektin privat fitues për një afat deri në 10 (dhjetë) vjet.

#### **Neni 14**

1. Subjekti privat, me transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së lidhur me peshkimin, garanton mosndryshimin e destinacionit dhe të qëllimit të saj, si dhe është përgjegjës për shfrytëzimin racional të infrastrukturës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Menaxhimi i infrastrukturës kryhet duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të veprimtarisë së peshkimit dhe tregtimit të produkteve peshkore, si dhe duke garantuar ruajtjen e interesit publik dhe rritjen e vlerës ekonomike të saj.
3. Transferimi i menaxhimit nuk krijon të drejta reale mbi pasurinë publike.

### **KREU VI**

#### **TË ARDHURAT NGA MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË PESHKIMIT**

##### **Neni 1**

Të ardhurat e krijuara nga menaxhimi i infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin përdoren nga subjektet menaxhuese për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës, në përputhje me kushtet e kontratës.

Përdorimi i të ardhurave duhet të garantojë ruajtjen e funksionit publik të infrastrukturës dhe rritjen e vlerës së saj ekonomike.

Të ardhurat e krijuara nga kontratat e lidhura sipas kreut V të këtij vendimi shkojnë në buxhetin e shtetit.

## **KREU VII MONITORIMI I KONTRATËS**

### **Neni 1**

Monitorimi i kontratave për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin kryhet nga institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës.

### **Neni 2**

Pranë institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës, me urdhër të titullarit, ngrihet dhe funksionon Njësia e Monitorimit të Kontratave për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin.

### **Neni 3**

Njësia e Monitorimit të Kontratave kryen këto detyra:

1. pas lidhjes së kontratës, bën dorëzimin e objektit të pala nënshkruese, me procesverbal, sipas genplanit përkatës. Në procesverbal përshkruhet gjendja fizike e infrastrukturës, vlera kontabël e saj, si dhe dokumentohet me pamje fotografike;
2. në përfundim të afatit të kontratës ose në rast zgjidhjeje të saj përpara afatit, merr në dorëzim objektin me procesverbal, duke evidentuar gjendjen e tij;
3. ndjek në vijimësi zbatimin e kushteve të kontratës dhe, çdo 6 (gjashtë) muaj, harton raporte monitorimi për subjektet nënshkruese dhe propozon masat përkatëse të titullari i institucionit përgjegjës;
4. Mban regjistrin e të dhënave mbi kontratat dhe të ardhurat e krijuara nga përdorimi i infrastrukturës publike;
5. Harton raporte përmbledhëse: brenda muajit korrik për gjashtëmujorin e parë dhe brenda muajit janar të vitit pasardhës për vitin pararendës, të cilat i paraqiten ministrit përgjegjës për peshkimin.

## **KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 1**

Në përfundim të procedurës së transferimit, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës depoziton një kopje të plotë të dokumentacionit të procedurës së transferimit të menaxhimit të infrastrukturës, në formë shkresore dhe elektronike, pranë ministrisë përgjegjëse për peshkimin.

### **Neni 2**

Deri në momentin e krijimit të shërbimit përkatës në e-Albania, procedura e konkurrimit publik sipas kreut III dhe V të këtij vendimi zhvillohet me paraqitjen e dokumentacionit pranë institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës.

### **Neni 3**

Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës për zbatimin e këtij vendimi.

### **Neni 4**

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 347, datë 22.5.2019 *“Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave të transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit tek organizatat e peshkimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private”*, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**

**Edi Rama**

SHTOJCA I

**KONTRATË TIP**  
**PËR TRANSFERIMIN E MENAXHIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË PESHKIMIT**  
**NDËRMJET INSTITUCIONIT PËRGJEGJËS PËR SHËRBIMET E PESHKIMIT DHE**  
**AKUAKULTURËS DHE ORGANIZATËS SË PESHKIMIT**

Kjo kontratë është hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë,

Neni 1

**Palët**

Palët në këtë kontratë janë:

- Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës,
- \_\_\_\_\_, identifikuar me NIPT \_\_\_\_\_, me adresë në \_\_\_\_\_, përfaqësuar nga \_\_\_\_\_.

Neni 2

**Qëllimi i kontratës**

Qëllimi i kësaj kontrate është transferimi i menaxhimit të

\_\_\_\_\_ (infrastrukturës së peshkimit)  
tek organizata e peshkimit, duke përcaktuar kushtet për kryerjen e veprimtarive, të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Neni 3

**Kohëzgjatja**

Kjo kontratë ndërmjet palëve të lartpërmendura lidhet për një afat prej \_\_\_\_\_ vjetësh, afat i cili fillon nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 4

**Territori i infrastrukturës peshkimit që transferohet në menaxhim**

1. Sipërfaqet dhe objektet që transferohen në menaxhim identifikohen me genplanin, që i bashkëlidhet kontratës dhe dokumentacionin e lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.
2. Pala, që merr në menaxhim, detyrohet të ruajë sipërfaqen dhe ambientet që merr në menaxhim.

## Neni 5

### **Ruajtja e destinacionit dhe e interesit publik**

Organizata e peshkimit, gjatë menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit zbaton kushtet e parashikuara në ligjin nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, duke garantuar:

- a) mosndryshimin e destinacionit dhe qëllimit;
- b) përdorimin e infrastrukturës së peshkimit nga ana institucioneve shtetërore në rastet e masave të jashtëzakonshme ose sa herë i kërkohet;
- c) ruajtjen dhe garantimin e interesit publik;
- ç) ruajtjen dhe rritjen vlerës ekonomike të strukturave portuale të peshkimit që i janë transferuar për menaxhim, duke riparuar infrastrukturën ekzistuese, përmirësuar infrastrukturën ekzistuese, në funksion të peshkimit.

## Neni 6

### **Përgjegjësitë e organizatës së peshkimit**

1. Organizata e peshkimit duhet të përdorë infrastrukturën e transferuar në mënyrë të drejtë e të barabartë, duke iu ofruar mundësinë të gjithë anëtarëve, veprimtaria e të cilëve lidhet me infrastrukturën, në mënyrë që të nxisin dhe të mbrojnë interesat e tyre.
2. Organizata e peshkimit merr përsipër përballimin e kostove të përdorimit dhe të mirëmbajtjes së infrastrukturës së peshkimit dhe përgjigjet për mirëmbajtjen e saj.
3. Organizata e peshkimit duhet të administrojë infrastrukturën e peshkimit në mënyrë racionale, duke zbatuar legjislacionin në fuqi për të nxitur mbrojtjen e mjedisit dhe një zhvillim të qëndrueshëm.
4. Organizata e peshkimit është përgjegjëse për sigurinë dhe sigurimin në territorin që ka në menaxhim.
5. Çdo investim i kryer në infrastrukturë pavarësisht nga vlera duhet të marrë më parë miratim nga institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturën.
6. Organizata e peshkimit detyrohet të raportojë çdo 6 muaj pranë institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe për akuakulturën lidhur me zbatimin e planit të menaxhimit, të shoqëruar me dokumentacion përkatës provues.
7. Organizata e peshkimit detyrohet të depozitojë në çdo kohë çdo informacion të kërkuar, si dhe të krijojë akses për inspektimin e dokumentacionit teknik e financiar.

## Neni 7

### **Të drejtat dhe detyrat e institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës**

1. Në përfundim të vitit të parë të zbatimit të Kontrates, në varësi të performancës së organizatës së peshkimit dhe efektivitetit ekonomik, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës, nëse vlerëson se kjo formë menaxhimi e infrastrukturës, nuk është efektive, ka të drejtë të zgjidhe në mënyrë të njëanshme Kontraten. Në këtë rast, institucioni përgjegjës për

shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës nuk mban përgjegjësi ligjore, përfshirë edhe përgjegjësi financiare, ndaj palës.

2. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës detyrohet të kontrollojë/mbikqyrë infrastrukturën e transferuar, dokumentacionin dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe të kontratës.

#### Neni 8 **Mbikqyrja**

Organizata e peshkimit duhet të krijojë të gjitha kushtet për mbikqyrjen nga ana e organeve shtetërore, të ngarkuara nga ligji, të infrastrukturës së peshkimit dhe të infrastrukturave të lidhura me peshkimin, që ajo administron.

#### Neni 9 **Marrëdhëniet e organizatës së peshkimit me organet shtetërore**

1. Kompetencat dhe përgjegjësitë e zyrës së kapitenarisë së portit ndaj anijeve të peshkimit, ekuipazheve të tyre dhe koordinimit të veprimtarive të lundrimit rregullohen në bazë të ligjeve në fuqi dhe të Kodit Detar. Organizata e peshkimit bashkëpunon me kapitanerinë si në drejtim të këmbimit të informacionit të mbërritjes e largimit të anijeve, ashtu edhe për lëvizjen e anijeve brenda portit.
2. Organizata e peshkimit bashkëpunon me kapitanarinë dhe regjistrin detar për ndjekjen në vazhdimësi të çështjeve që lidhen me sigurimin e lundrimit të anijeve mbi bazën e konventave ndërkombëtare.
3. Organizata e peshkimit bashkëpunon dhe i krijon kushtet e duhura administratës doganore në mënyrë që ajo të kryejë detyrat funksionale të saj brenda territorit të portit të peshkimit.
4. Organizata e peshkimit bashkëpunon me policinë kufitare dhe migracionit, me qëllim që të sigurojë zhvillimin normal të veprimtarive në portin e peshkimit.

#### Neni 10 **Dokumentacioni**

Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës dhe organizata e peshkimit kryejnë inventarin e infrastrukturës së peshkimit, të cilin e merr në ngarkim së bashku me dokumentacionet përkatëse.

#### Neni 11 **Mbarimi i kontratës**

1. Kjo kontratë mbaron kur përfundon afati i përcaktuar në nenin 3 të saj;
2. Kjo kontratë mbaron para afatit të përcaktuar në nenin 3 të saj:
  - a) me shpërndarjen e organizatës së peshkimit
  - b) kur organizata e peshkimit nuk kryen menaxhimin sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë;

- c) kur organizata e peshkimit shkel parashikimet e ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar ose kur ndryshohet destinacioni për të cilin është kryer transferimi;
- ç) kur nuk përmbushen detyrimet sipas planit të menaxhimit, mbi të cilin është kryer transferimi.
- dh) me mirëkuptim mes palëve.

#### Neni 12

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Palët respektojnë legjislacionin në fuqi dhe përpiqen që mosmarrëveshjet, të cilat mund të lindin gjatë zbatimit të saj, t'i zgjidhin me mirëkuptim midis tyre.
2. Pala që gjykon se ekziston një mosmarrëveshje, njofton palën tjetër duke bërë një përshkrim të plotë të çështjeve që kërkojnë zgjidhje.
3. Nëse palët nuk zgjidhin mosmarrëveshjet, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit, njëra palë njofton palën tjetër se çështja nuk është zgjidhur.
4. Për të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent është gjykata për çështjet administrative.

#### Neni 13

#### **Të ndryshme**

1. Kjo kontratë nënshkruhet në 4 kopje origjinale, nga 2 për secilën palë.
2. Çdo ndryshim i kësaj kontrate duhet të negociohet ndërmjet palëve dhe të bëhet me shkrim.

PALËT NËNSHKRUESE